

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
NDËRMARRJA E PASURISË PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

DATA: ____/____/ 2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – MALLRA

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE MJETE PËR NEVOJAT E NPP” – 4 LOTE:

LOTI 1 – Blerje Automjet Fuoristradë 4x4 (Pick-up)

LOTI 2 – Blerje Fadromë

LOTI 3 – Blerje Kamionçinë me platformë ajrore (kosh) dhe vinç hidraulik

LOTI 4 – Blerje Kamionçinë Vetëshkarkuese (Dopio Kabinë)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Automjete 34100000-8 ; Kamionçina 34136200-1 ; Automjete të rënda 34140000-0.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës:

10,100,000(dhjetë milionë e njëqind mijë) LEKË PA TVSH.

Ndarë në 4 lote:

LOTI 1 – Blerje Automjet Fuoristradë 4x4 (Pick-up) – 1,700,000 (një milionë e shtatëqind mijë) LEKË PA TVSH.

LOTI 2 – Blerje Fadromë - 4,000,000 (katër milionë) LEKË PA TVSH.

LOTI 3 – Blerje Kamionçinë me platformë ajrore (kosh) dhe vinç hidraulik - 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) LEKË PA TVSH.

LOTI 4 – Blerje Kamionçinë Vetëshkarkuese (Dopio Kabinë) - 1,900,000 (një milionë e nëntëqind mijë) LEKË PA TVSH.

Vlera e fondit limit është përcaktuar bazuar në mesataren e tre ofertave të marra nga grupi i punës i ngritur me Urdhërin Nr 161.prot datë: 12/08/2026 konform nenit 34, 35 dhe 36 të Ligjit Nr 162/2021 “Për Prokurimin Publik”.

Vënë në dispozicion nga: BUXHETI I SHTETIT + VETËFINANCIM.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti/enti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- EN-ISO 9001 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (në lidhje me objektin e tenderit).
- Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

ARGUMENTIM: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Kopje te deklaratave te xhiros vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar te kontrates.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin gjejmë te përcaktuar se: “*Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës*”, në pikat 1,2 (b) ,3 të nenit 43, si dhe në nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,. Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025, të konfirmuara nga organet tatimore, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, "Gjithashtu Autoritetet ose Entet Kontraktore mund të kërkojnë që Operatorët ekonomik të japin informacione në Bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit" LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe mallrat e furnizuara

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe mallrat e furnizuara.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

LOTI 1 - “AUTOMJET FUORISTRADË 4X4 (PICK-UP)”

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike (në gjuhën shqipe origjinal ose i përkthyer dhe i noterizuar) për mjetin objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara.

- Në katalogun/skedën teknike përkatëse të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike.
- Në katalog/skedë teknike duhet të pasqyrohen të dhënat e mjetit, modeli, viti i prodhimit i tij si edhe çdo e dhënë tjetër teknike.
- Mjeti duhet të jetë i shoqëruar me Foto të tij ku tregojnë gjendjen aktuale.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 (pika 6.b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogët teknikë”.

Ky kriter është vendosur për të patur një pamje vizuale të mjetit për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE sipas specifikimeve teknike.

3.1 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një vetëdeklarim nëpërmjet të cilës marrin përsipër që garancia për eliminimin, pa shpërblim, të defekteve të mundshme do të jetë 12

(dymbëdhjetë) muaj nga data e marrjes së mjeteve në dorëzim, (përfshihen rastet kur vërtetohet se defekti është shkaktuar nga pakujdesia e shoferit ose keqpërdorimi i mjetit)”.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 (pika 8) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

Kërkesa për një periudhë garancie prej 12 muajsh nga data e dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të mjetit është përcaktuar me qëllim garantimin e cilësisë, funksionalitetit dhe përputhshmërisë së mjetit të furnizuar me specifikimet teknike dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentet e procedurës së prokurimit.

Mjeti përbën një aset që do të përdoret në mënyrë të vazhdueshme për përmbushjen e funksioneve të Autoritetit Kontraktor dhe, për shkak të natyrës së tij teknike dhe mekanike, gjatë periudhës së përdorimit mund të evidentohen defekte apo problematika që nuk janë të konstatueshme në momentin e dorëzimit.

Përcaktimi i një garancie minimale 12-mujore synon të sigurojë që, në rast të shfaqjes së defekteve të lidhura me cilësinë, materialet, komponentët ose funksionimin e mjetit, operatori ekonomik/furnitori të mbajë përgjegjësinë për riparimin ose zëvendësimin e pjesëve përkatëse, sipas kushteve të garancisë, pa krijuar kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

Kjo kërkesë është e arsyeshme dhe proporcionale me objektin e prokurimit, pasi periudha 12-mujore i jep Autoritetit Kontraktor një periudhë të mjaftueshme për të verifikuar në kushte reale përdorimi qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e mjetit. Në të njëjtën kohë, kërkesa nuk lidhet me një markë, model apo prodhues të caktuar dhe nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garantimin e një niveli minimal cilësie dhe sigurie në furnizimin e realizuar.

Garancia 12-mujore shërben gjithashtu si mekanizëm për mbrojtjen e fondeve publike, pasi redukton riskun që Autoriteti Kontraktor të përballojë shpenzime të paparashikuara për defekte që lidhen me furnizimin e mjetit gjatë periudhës fillestare të përdorimit.

Për sa më sipër, kërkesa për garanci minimale 12 muaj konsiderohet e nevojshme, objektive dhe në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës, duke synuar sigurimin e një mjeti funksional, cilësor dhe të përshtatshëm për përdorimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

3.2 Për mjetin, operatori ekonomik duhet të paraqes dokumentacionin si mëposhtë:

- Deklaratën doganore të mjetit, e cila vërteton shlyerjen e detyrimeve doganore në R.SH.
- Dokumentacionin e origjinës të mjetit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur dhe me paraqitjen e një deklaratë se dokumentacioni i kërkuar do të dorëzohet fizikisht pranë AK përpara lidhjes së kontratës në rast të shpalljes fitues të operatorit ekonomik.

ARGUMENTIMI:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 (pika 8) të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se:“*Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*”.

Kërkesa që operatori ekonomik i shpallur fitues, përpara lidhjes dhe/ose gjatë zbatimit të kontratës, të paraqesë deklaratën doganore të mjetit që vërteton shlyerjen e detyrimeve doganore në Republikën e Shqipërisë, si dhe dokumentacionin që provon origjinën e mjetit, është përcaktuar me qëllim garantimin e ligjshmërisë së furnizimit dhe mbrojtjen e interesit publik.

Duke qenë se objekti i prokurimit është furnizimi me një mjet, Autoriteti Kontraktor ka interes të ligjshëm të sigurohet se mjeti që do të dorëzohet është futur dhe qarkullon në mënyrë të ligjshme në Republikën e Shqipërisë dhe se për të janë përmbushur detyrimet doganore përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Paraqitja e deklaratës doganore synon të verifikojë se për mjetin janë përmbushur detyrimet doganore të aplikueshme dhe se furnizimi nuk krijon për Autoritetin Kontraktor risk financiar apo juridik që mund të rrjedhë nga detyrime të papaguara apo nga një status doganor i parregullt.

Në mënyrë të ngjashme, kërkesa për dokumentacionin e origjinës së mjetit synon të mundësojë identifikimin dhe verifikimin e origjinës së mjetit, gjurmueshmërinë e tij dhe përputhjen e dokumentacionit të paraqitur me mjetin që do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktor.

Këto dokumente janë të nevojshme edhe për të siguruar që mjeti i furnizuar mund të kryejë procedurat e nevojshme administrative për regjistrimin dhe përdorimin e tij nga Autoriteti Kontraktor, duke shmangur problematika të mëvonshme lidhur me dokumentacionin, origjinën, statusin doganor apo pronësinë e mjetit.

Kërkesat e mësipërme nuk synojnë favorizimin e një operatori ekonomik, marke apo prodhuesi të caktuar, por vendosin kërkesa objektive për dokumentacionin që duhet të shoqërojë mjetin e furnizuar. Për rrjedhojë, ato konsiderohen të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës dhe me nevojën e Autoritetit Kontraktor për të marrë në dorëzim një mjet të dokumentuar, të gjurmueshëm dhe të ligjshëm për përdorim në Republikën e Shqipërisë.

Për sa më sipër, kërkesa për paraqitjen e deklaratës doganore që vërteton përmbushjen e detyrimeve doganore, si dhe të dokumentacionit të origjinës së mjetit, është vendosur me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së furnizimit, garantimin e gjurmueshmërisë së mjetit, shmangien e risqeve financiare dhe juridike për Autoritetin Kontraktor dhe sigurimin e përdorimit të ligjshëm të mjetit të blerë me fonde publike.

3.3 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se nëse shpallet fitues do të mbulojnë të gjitha shpenzimet për kalimin e pronësisë së mjetit në emër të AK.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 (pika 8) të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

Ky kriter është vendosur për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe kalimin e pronësisë pa patur kosto shtesë për AK-në pasi ky i fundit nuk ka parashikuar kosto të tjera.

3.4 Operatori Ekonomik i shpallur fitues përpara nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës për mjetin si mëposhtë:

- Leje qarkullimi

-Siguracion TPL

-Kontroll teknik i vlefshëm me cilësinë “KALON”

Kriteri konsiderohet i përmbushur dhe me paraqitjen e një deklarate se dokumentacioni i kërkuar do të dorëzohet fizikisht pranë AK përpara lidhjes së kontratës në rast të shpalljes fitues të operatorit ekonomik.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 (pika 8) të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

Kërkesa që operatori ekonomik i shpallur fitues të paraqesë, përpara dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të mjetit, lejen e qarkullimit, siguracionin e detyrueshëm TPL dhe dokumentin e kontrollit teknik të vlefshëm, është përcaktuar me qëllim garantimin e ligjshmërisë, sigurisë dhe përdorshmërisë së mjetit objekt të kontratës.

Leja e qarkullimit kërkohet me qëllim verifikimin e të dhënave identifikuese dhe teknike të mjetit, si dhe të statusit të tij të regjistrimit. Paraqitja e këtij dokumenti i mundëson Autoritetit Kontraktor të verifikojë që mjeti që do të dorëzohet është i identifikueshëm dhe i dokumentuar në përputhje me kërkesat ligjore për qarkullimin e mjeteve rrugore.

Siguracioni i detyrueshëm TPL kërkohet për të garantuar që mjeti të jetë i mbuluar nga sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësisë ndaj palëve të treta, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me nevojën për të mundësuar përdorimin e mjetit në mënyrë të ligjshme dhe për të reduktuar ekspozimin e Autoritetit Kontraktor ndaj risqeve që mund të lindin gjatë përdorimit të tij.

Kontrolli teknik i vlefshëm kërkohet me qëllim verifikimin se mjeti plotëson kërkesat teknike dhe të sigurisë të përcaktuara për qarkullimin në rrugë. Për një mjet që do të përdoret për kryerjen e funksioneve të Autoritetit Kontraktor, është e nevojshme që ai të jetë në gjendje të përshtatshme teknike dhe të mund të përdoret menjëherë pas marrjes në dorëzim, pa qenë nevoja për përbushjen e procedurave të mëtejshme që mund të pengojnë përdorimin e tij.

Kërkesa për këto dokumente synon gjithashtu të sigurojë që Autoriteti Kontraktor të mos marrë në dorëzim një mjet i cili, pavarësisht përbushjes së specifikimeve teknike të kërkuara, nuk është i pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për qarkullim dhe përdorim të ligjshëm.

Këto kërkesa janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe nuk synojnë kufizimin apo favorizimin e operatorëve ekonomikë, por verifikimin e statusit ligjor, dokumentacionit, sigurisë teknike dhe gatishmërisë për përdorim të mjetit.

Për sa më sipër, kërkesa për paraqitjen e lejes së qarkullimit, siguracionit TPL dhe kontrollit teknik të vlefshëm konsiderohet e nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të marrë në dorëzim një mjet të dokumentuar, të siguruar, teknikisht të kontrolluar dhe të gatshëm për përdorim të ligjshëm.

3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportimit të mjetit në adresën e Autoritetit Kontraktor.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 (pika 8) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

Ky deklaram kërkohet për t’i vërtetuar dhe garantuar AK-së realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallit objekt prokurimi gjithashtu edhe sepse AK nuk ka parashikuar kosto të tjera.

LOTI 2 - BLERJE FADROMË

4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike(në gjuhën shqipe origjinal ose i përkthyer dhe i noterizuar) për mjetet objekt prokurimi, me qëllim përbushjen e specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara.

- Në katalogun/skedën teknike përkatëse të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike.
- Në katalog/skedë teknike duhet të pasqyrohen të dhënat e mjetit, modeli, viti i prodhimit i tij si edhe çdo e dhenë tjetër teknike.
- Mjeti duhet të jetë i shoqëruar me Foto të tij ku tregojnë gjendjen aktuale.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 (pika 6.b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b)fotografitë apo katalogët teknikë”.

Ky kriter është vendosur për të patur një pamje vizuale të mjetit për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE sipas specifikimeve teknike.

4.1 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një vetëdeklarim nëpërmjet së cilës merr përsipër që garancia për eliminimin, pa shpërblim, të defekteve të mundshme do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e marrjes së mjetit në dorëzim, (përfshihen rastet kur vërtetohet se defekti është shkaktuar nga pakujdesia e shoferit ose keqpërdorimi i mjetit”).

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 (pika 8) të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,ku përcaktohet se:“*Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

Kërkesa për një periudhë garancie prej 12 muajsh nga data e dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të mjetit është përcaktuar me qëllim garantimin e cilësisë, funksionalitetit dhe përputhshmërisë së mjetit të furnizuar me specifikimet teknike dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentet e procedurës së prokurimit.

Mjeti përbën një aset që do të përdoret në mënyrë të vazhdueshme për përmbushjen e funksioneve të Autoritetit Kontraktor dhe, për shkak të natyrës së tij teknike dhe mekanike, gjatë periudhës së përdorimit mund të evidentohen defekte apo problematika që nuk janë të konstatueshme në momentin e dorëzimit.

Përcaktimi i një garancie minimale 12-mujore synon të sigurojë që, në rast të shfaqjes së defekteve të lidhura me cilësinë, materialet, komponentët ose funksionimin e mjetit, operatori ekonomik/furnitori të mbajë përgjegjësinë për riparimin ose zëvendësimin e pjesëve përkatëse, sipas kushteve të garancisë, pa krijuar kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

Kjo kërkesë është e arsyeshme dhe proporcionale me objektin e prokurimit, pasi periudha 12-mujore i jep Autoritetit Kontraktor një periudhë të mjaftueshme për të verifikuar në kushte reale përdorimi qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e mjetit. Në të njëjtën kohë, kërkesa nuk lidhet me një markë, model apo prodhues të caktuar dhe nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garantimin e një niveli minimal cilësie dhe sigurie në furnizimin e realizuar.

Garancia 12-mujore shërben gjithashtu si mekanizëm për mbrojtjen e fondeve publike, pasi redukton riskun që Autoriteti Kontraktor të përballojë shpenzime të paparashikuara për defekte që lidhen me furnizimin e mjetit gjatë periudhës fillestare të përdorimit.

Për sa më sipër, kërkesa për garanci minimale 12 muaj konsiderohet e nevojshme, objektive dhe në përpjesëtim me natyrën dhe objektin e kontratës, duke synuar sigurimin e një mjeti funksional, cilësor dhe të përshtatshëm për përdorimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

4.2 Për mjetin, operatori ekonomik duhet të paraqes dokumentacionin si me poshtë:

- Deklaratën doganore të mjetit, e cila vërteton shlyerjen e detyrimeve doganore në R.SH.
- Dokumentacionin e origjinës të mjetit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur dhe me paraqitjen e një deklarate se dokumentacioni i kërkuar do të dorëzohet fizikisht pranë AK përpara lidhjes së kontratës në rast të shpalljes fitues të operatorit ekonomik.

ARGUMENTIMI:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 (pika 8) të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

Kërkesa që operatori ekonomik i shpallur fitues, përpara lidhjes dhe/ose gjatë zbatimit të kontratës, të paraqesë deklaratën doganore të mjetit që vërteton shlyerjen e detyrimeve doganore në Republikën e Shqipërisë, si dhe dokumentacionin që provon origjinën e mjetit, është përcaktuar me qëllim garantimin e ligjshmërisë së furnizimit dhe mbrojtjen e interesit publik.

Duke qenë se objekti i prokurimit është furnizimi me një mjet, Autoriteti Kontraktor ka interes të ligjshëm të sigurohet se mjeti që do të dorëzohet është futur dhe qarkullon në mënyrë të ligjshme në Republikën e Shqipërisë dhe se për të janë përmbushur detyrimet doganore përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Paraqitja e deklaratës doganore synon të verifikojë se për mjetin janë përmbushur detyrimet doganore të aplikueshme dhe se furnizimi nuk krijon për Autoritetin Kontraktor risk financiar apo juridik që mund të rrjedhë nga detyrime të papaguara apo nga një status doganor i parregullt.

Në mënyrë të ngjashme, kërkesa për dokumentacionin e origjinës së mjetit synon të mundësojë identifikimin dhe verifikimin e origjinës së mjetit, gjurmueshmërinë e tij dhe përputhjen e dokumentacionit të paraqitur me mjetin që do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktor.

Këto dokumente janë të nevojshme edhe për të siguruar që mjeti i furnizuar mund të kryejë procedurat e nevojshme administrative për regjistrimin dhe përdorimin e tij nga Autoriteti Kontraktor, duke shmangur problematika të mëvonshme lidhur me dokumentacionin, origjinën, statusin doganor apo pronësinë e mjetit.

Kërkesat e mësipërme nuk synojnë favorizimin e një operatori ekonomik, marke apo prodhuesi të caktuar, por vendosin kërkesa objektive për dokumentacionin që duhet të shoqërojë mjetin e furnizuar. Për rrjedhojë, ato konsiderohen të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës dhe me nevojën e Autoritetit Kontraktor për të marrë në dorëzim një mjet të dokumentuar, të gjurmueshëm dhe të ligjshëm për përdorim në Republikën e Shqipërisë.

Për sa më sipër, kërkesa për paraqitjen e deklaratës doganore që vërteton përmbushjen e detyrimeve doganore, si dhe të dokumentacionit të origjinës së mjetit, është vendosur me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së furnizimit, garantimin e gjurmueshmërisë së mjetit, shmangien e risqeve financiare dhe juridike për Autoritetin Kontraktor dhe sigurimin e përdorimit të ligjshëm të mjetit të blerë me fonde publike.

4.3 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se nëse shpallet fitues do të mbulojnë të gjitha shpenzimet për kalimin e pronësisë së mjetit në emër të AK “Ndërmarrja e Pasurisë Publike”.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 (pika 8) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

Ky kriter është vendosur për të garanzuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe kalimin e pronësisë pa patur kosto shtesë për AK-në pasi ky i fundit nuk ka parashikuar kosto të tjera.

4.4 Operatori Ekonomik i shpallur fitues përpara nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës për mjetin si mëposhtë:

- Leje qarkullimi

-Siguracion TPL

-Kontroll teknik i vlefshëm me cilësinë “KALON”

Kriteri konsiderohet i përmbushur dhe me paraqitjen e një deklaratë se dokumentacioni i kërkuar do të dorëzohet fizikisht pranë AK përpara lidhjes së kontratës në rast të shpalljes fitues të operatorit ekonomik

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 (pika 8) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

Kërkesa që operatori ekonomik i shpallur fitues të paraqesë, përpara dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të mjetit, lejen e qarkullimit, siguracionin e detyrueshëm TPL dhe dokumentin e kontrollit

teknik të vlefshëm, është përcaktuar me qëllim garantimin e ligjshmërisë, sigurisë dhe përdorshmërisë së mjetit objekt të kontratës.

Leja e qarkullimit kërkohet me qëllim verifikimin e të dhënave identifikuese dhe teknike të mjetit, si dhe të statusit të tij të regjistrimit. Paraqitja e këtij dokumenti i mundëson Autoritetit Kontraktor të verifikojë që mjeti që do të dorëzohet është i identifikueshëm dhe i dokumentuar në përputhje me kërkesat ligjore për qarkullimin e mjeteve rrugore.

Siguracioni i detyrueshëm TPL kërkohet për të garantuar që mjeti të jetë i mbuluar nga sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësisë ndaj palëve të treta, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me nevojën për të mundësuar përdorimin e mjetit në mënyrë të ligjshme dhe për të reduktuar ekspozimin e Autoritetit Kontraktor ndaj risqeve që mund të lindin gjatë përdorimit të tij.

Kontrolli teknik i vlefshëm kërkohet me qëllim verifikimin se mjeti plotëson kërkesat teknike dhe të sigurisë të përcaktuara për qarkullimin në rrugë. Për një mjet që do të përdoret për kryerjen e funksioneve të Autoritetit Kontraktor, është e nevojshme që ai të jetë në gjendje të përshtatshme teknike dhe të mund të përdoret menjëherë pas marrjes në dorëzim, pa qenë nevoja për përmbushjen e procedurave të mëtejshme që mund të pengojnë përdorimin e tij.

